



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1235/5 Prot

Tiranë, më 10/9/2019

VENDIM

Nr. 29, datë 10.9.2019

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____ ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") Formularin e Ankesës nr. 1235 prot., datë 08.08.2019, me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*", kundër Autoritetit Publik "Ujësajllës Kanalizime Durrës sh.a" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Ankuesi, nëpërmjet kërkesës së datës 10.07.2019, depozituar nëpërmjet adresës elektronike info@ukdurrës.al, ka kërkuar t'i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni lidhur me rrjetin e kanalizimeve të cilat përkrahin zonën e ish-Kënetës, Njësia Administrative nr.6, Bashkia Durrës dhe më konkretisht:

1. *A ka një studim (masterplan) për zhvillimin e zonës dhe konkretisht konceptimin dhe planifikimin e kanalizimeve të ujërave të ndotur, atyre të përdorura dhe të shiut?*
2. *Listën me investimet për rrjetin e kanalizimeve në Njësinë Administrative nr.6, për vitet 2010 – qershor 2019, shoqëruar me zërat financiar përkatës;*
3. *A ka lagje në Njësinë Administrative nr.6, të cilat janë të lidhura me rrjetin e kanalizimeve që përfundon në Impiantin e Trajtimit të Ujërave të Ndotura?*
4. *A e paguajnë banorët e ish-Kënetës në faturën mujore të konsumit tarifën për largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotur?*
5. *A ka ndërmarrë inspektoriat i Ujësajllës Kanalizime Durrës inspektime për ndërprerjen e shkarkimeve që derdhen ujëra të ndotur në kanalet e hapura në ish-Kënetë?*

6. *Listën me investimet e realizuara dhe të parashikuara për rrjetin e kanalizimeve në Njësinë Administrative nr.6, përgjatë vitit 2019, nëse ka.*

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, z. [] ka paraqitur ankim pranë Zyrës së Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Zyra e Komisionerit, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, me shkresën nr. 1235/1 prot., datë 08.08.2019 ka kërkuar nga Autoriteti Publik vlerësimin e dhënies së informacionit.

Me shkresën nr. 1708/1 prot., datë 20.08.2019, Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje, duke sqaruar ndër të tjera se: *“Ujësjetllës Kanalizime Durrës (UKD) është një shoqëri që mban marrëdhënie korrekte me përfaqësues të medias si në nivel lokal, ashtu edhe në atë kombëtar. Në lidhje me kërkesat e gazetarit [] për dhënie informacioni, UKD ka vepruar me të njëjtën mënyrë dhe praktikë ashtu si me gazetarët e tjerë, derisa u konstatua se nga ana e tij në raste të përsëritura, ai nuk iu përmbahej informacioneve dhe të dhënave të UKD-së, por ka thënë në shkrimet dhe reportazhet e tij gjëra tërësisht të pavërteta duke dezinformuar publikun. Sa më sipër arsyeja e mosdhënies së informacionit nga ana e shoqërisë ka qenë pikërisht kjo, abuzimi dhe tjetërsimi me anën e montazhit të intervistës së marrë pranë UKD sh.a”.*

Me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” në të cilin citohet se *“Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”*, me shkresën nr. 1235/2 prot., datë 20.08.2019, Komisioneri ftoi palët në seancë dëgjimore, e cila u zhvillua me praninë e ankuesit z. [] dhe përfaqësuesve të Autoritetit Publik.

Gjatë seancës, pala ankuese dhe përfaqësuesit e Autoritetit Publik rikonfirmuan qëndrimet e tyre të reflektuara në aktet shkresore të trajtuara më sipër.

Duke qenë se detyrimi nuk është përmbushur, ankuesi ka vijuar me ankimin nr.1235/4 prot., datë 23.08.2019 duke pretenduar ndër të tjerat se: *“Argumentet e paraqitura nga Autoriteti Publik janë opinione të pabazuara në ligj dhe që bien ndesh me frymën e ligjeve që mbrojnë lirinë e shtypit”.*

Në vijim të shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se argumentet e parashtruara nga Autoriteti Publik për mosvënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar, nuk qëndrojnë.

Qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik bie ndesh me qëllimin e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i cili është garantimi i njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike.

Në këtë frymë, Autoriteti Publik është i detyruar të zbatojë detyrimet e këtij ligji ndërsa përgjegjësia për tjetërsimin e informacioneve bie mbi individin që merr apo përdor këtë të fundit.

Në rast keqpërdorimi të informacionit publik nga ana e kërkuarit, Autoriteti Publik ka në dispozicion instrumentet ligjore të vëna në dispozicion nga legjislativi në fuqi.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se informacioni/dokumentacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", sipas të cilit "*informacion publik*" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik".

Rrjedhimisht, ekzistenca e dokumentacionit të mësipërm, pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit për dhënien e informacionit dhe vënien e tij në dispozicion të kërkuarit.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, "*Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*".

Sa i përket përgjegjësisë për refuzimin e dhënies së informacionit, Komisioneri konstaton se Autoriteti Publik nuk ka caktuar një koordinator për të drejtën e informimit. Rrjedhimisht, përgjegjësia në rastin konkret bie mbi personin i cili ka refuzuar vënien në dispozicion të informacionit publik, duke veshur në këtë mënyrë cilësitë e koordinatorit *ad hoc*. Nga praktika e administruar nga Zyra e Komisionerit, rezulton se të dyja shkresat e Autoritetit Publik, dhe më konkretisht shkresa nr. 1708/1 prot., datë 20.08.2019 dhe shkresa nr. 1708/2 Prot., datë 23.08.2019, në të cilën rikonfirmohet qëndrimi refuzues i paraqitur në seancën dëgjimore, janë nënshkruar nga N/Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Publik, z. Kasem Bejko.

Sa më sipër, për rastin konkret, N/Drejtori i Përgjithshëm në Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a, ka vepruar në cilësinë e koordinatorit *ad hoc* për të drejtën e informimit, duke marrë dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga ky rol.

Në bazë të nenit 18, pika 2, gërma a) e Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" refuzimi për dhënien e informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë e cila varion nga 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë deri në 300.000 (treqind mijë) Lekë.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e z. ndaj Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në shkronjën a) të pikës 2 të nenit 18, pikën 3 të nenit 18, pikën 3 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22, shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet

administrative”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankimit nr. 1235 Prot., datë 08.08.2019 të z. _____, kundër Autoritetit Publik “Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar lidhur me rrjetin e kanalizimeve të cilat përshkrojnë zonën e ish-Kënetës, Njësia Administrative nr.6, Bashkia Durrës dhe më konkretisht:
 1. A ka një studim (masterplan) për zhvillimin e zonës dhe konkretisht konceptimin dhe planifikimin e kanalizimeve të ujërave të ndotur, atyre të përdorura dhe të shiut?
 2. Listën me investimet për rrjetin e kanalizimeve në Njësinë Administrative nr.6, për vitet 2010 – qershor 2019, shoqëruar me zërat financiar përkatës;
 3. A ka lagje në Njësinë Administrative nr.6, të cilat janë të lidhura me rrjetin e kanalizimeve që përfundon në Impiantin e Trajtimit të Ujërave të Ndotura?
 4. A e paguajnë banorët e ish-Kënetës në faturën mujore të konsumit tarifën për largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotur?
 5. A ka ndërmarrë inspektoriati i Ujësjellës Kanalizime Durrës inspektime për ndërprerjen e shkarkimeve që derdhin ujëra të ndotur në kanalet e hapura në ish-Kënetë?
 6. Listën me investimet e realizuara dhe të parashikuara për rrjetin e kanalizimeve në Njësinë Administrative nr.6, përgjatë vitit 2019, nëse ka, brenda datës 17. 9 .2019.
3. Dënimin e N/Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin Publik, z. Kasem Bejko, në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë në përputhje me nenin 19, pika 3 e ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore. Gjoha ekzekutohet nga zyra e financës së Autoritetit Publik brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Kundër vendimmarrjes në pikat 1, dhe 2, palët kanë të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
5. Kundër vendimmarrjes në pikën 3, personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ, ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
6. Ky vendim u shpall sot në datë 10. 9 .2019.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

